

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Këlliçi, akuza Ramës pas fjalimit në OKB: Përdore antisemitizmin për të mbuluar skandalet e narkoshtetit
ADRESA	https://www.cna.al/politike/kellici-akuza-rames-pas-fjalimit-ne-okb-perdore-antisemitizm-in-per-te-m-i475327
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 12:29:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 12:20:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	98045ad534261a6e9d53064629c207e3ce11392bae50f440cfa551066ac8ad62
TEKSTI	2c619c573fe1c3248b4d61ff6987a27def3b5b6b129ca734072f842d390eabdd
PAMJA	4feae16fd9b72d3f43b4879c45d9b5583e7fc94ce92b80dd21a64c5b028d43f6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	67395288fa693d1c91e5df08815aad7fef3aff9a88582a6130c1a0a2aaf3dcde
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	8943aae4786784478314ed8f36e25f0bd32ee36cc85ad3e80ac7b853175904e3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/67395288fa693d1c91e5df08815aad7fef3aff9a88582a6130c1a0a2aaf3dcde>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

14:20 Politikë

Nënkryetari i Partisë Demokratike, Belind Këlliçi, ka hedh...

Këlliçi, akuza Ramës pas fjalimit në OKB: Përdore antisemitizmin për të mbuluar skandalet e narkoshtetit



27 Shtator 2026, 14:20, Politikë CNA



Nënkryetari i Partisë Demokratike, Belind Këlliçi, ka hedhur akuza ndaj Edi Ramës pas fjalës së këtij të fundit në Asambleenë e Përgjithshme të OKB-së, ku Rama foli ndër të tjera për antisemitizmin dhe ndikimin e manipulimit digjital në opinionin publik.

Këlliçi e akuzon kryeministrin se po përdor një prej temave me të njëjshme të historisë europiane për të zvendosur vëmendjen nga protestat dhe akuzat ndaj qeverisë.

“Antisemitizëm. Këtë fjalë zgjodhi Edi Rama të marrë me vete në OKB nga protesta e shqiptarëve kundër qeverisë së tij kriminale”, shkruan Këlliçi.

Sipas tij, Shqipëria ka një histori të veçantë në raport me hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe Rama, në vend që të përfaqësonte këtë histori, zgjodhi të fliste për antisemitizmin në kontekstin e zhvillimeve të fundit politike në vend.

Këlliçi pyeti Edi Ramën se, kush ishte vajza e maskuar që grisi një flamur izraelit pranë Ambasadës së Izraelit.

“Kush ishte? A u identifikua? A u mor në pyetje? A kishte lidhje me protestuesit? A veproi e vetme? Cili ishte motivi?”, shkruan Këlliçi në reagimin e tij në rrjetet sociale.

Deklarata e Këlliçit

Antisemitizëm.

Këtë fjalë zgjodhi Edi Rama të marrë me vete në OKB nga protesta e shqiptarëve kundër qeverisë së tij kriminale. E bëri në emër të një populli që ka një nga historitë më të jashtëzakonshme të besës në Europë, atë me hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Në kohën kur Europa i dorëzonte hebrenjtë të nazistët, shqiptarët i strehonin bujarisht në shtëpi me rrezikun mbi krye. U jepnin emra shqiptarë, dokumente, bukë, çati dhe mbi të gjitha, mbrojtje. Shqipëria doli nga Lufta e Dytë Botërore me më shumë hebrenj sesa kishte në fillim të saj.

Tetëdhjetë vjet më vonë, kryeministri i tyre nuk eksportoi nga Shqipëria në OKB këtë testament moral e fisnik, por plas publikisht syshqyer përdorimin e njërës prej fjalëve më të rënda të historisë njerëzore si kundërpeshë ndaj një revolte që kërkon prej 120 ditësh largimin e tij.

Tmerri i Holokaustit nuk mund të përdoret si pafytyrësi nga departamenti i komunikimit të Kryeministrit për të çfokusuar vëmendjen nga skandalet e narkoshtetit të vetëm në Europë, baba themelues i të cilit është vetë Edi Rama.

I damkosur, por pa cipë, nga foltorja e OKB-së i shpjegonte botës se si prodhohet manipulimi me Inteligjencë Artificiale, si ngarkohet me emocione, personalizohet, shumëfishohet dhe, në fund pakëtohet si realitet. Dhe mizorisht për ta shitur këtë mall që e njeht mirë, akuzoi publikisht popullin e tij. E padëgjuar më parë. Nuk ka guxuar ta bëjë këtë asnjë kryeministër në Europë, madje as nga vende ku ka popullsi emigrante dhe të integruar me ndjenja të theksuara anti izraelite.

Shqiptarët nuk kanë nevojë t'i japin askujt certifikatë pafajësie për antisemitizëm. Ama kryeministri duhet t'u përgjigjet shqiptarëve se pari se çfarë halli madhor po e detyron të lidhë Revolucionin e Flamingove, një protestë qytetare që lindi nga kundërshtimi ndaj një projekti në Zvërnec dhe u zgjerua në një revoltë kundër narko qeverisjes së tij me teza të rrezikshme antisemitizmi.

Kryeministri duhet t'u përgjigjet sidomos shqiptarëve edhe për një episod të pazbardhur.

Gjatë protestave, një vajzë e maskuar hoqi dhe grisi një flamur izraelit pranë Ambasadës së Izraelit. Por më pas vajza u zhduk nga historia.

Kush ishte? A u identifikua?

A u mor në pyetje? A kishte lidhje me protestuesit? A veproi e vetme?

Cili ishte motivi?

Meqë kryeministri “u mundua” gjër në OKB të fajësonte popullin e tij për antisemitizëm, pse nuk e shndërroi në proces madhor brenda vendit këtë çështje gjër në zbardhjen e plotë të saj?


Ka Policinë e Shtetit, struktura hetimore, shërbime inteligjence, ka kamera kudo, të infiltuara, sisteme sigurie rreth përfaqësive diplomatike. Pse nuk ia dogji shpirtin kjo shprehje flagrante antisemite? Pse nuk e zbuloi kurrë shteti i tij se kush ishte kjo vajzë që tentoi të ushqejë narrativën që vetë Rama përdori në foltoren e OKB-së?

Sa karagjoz ngjan kur pretendon se ka kuptuar mekanizmin e një operacioni kompleks të manipulimit digjital, mënyrën se si algoritmet depërtuan në “botët emocionale” të qytetarëve dhe transformuan një gënjeshtër në realitet politik, por identitetin e një vajze përpara një ambasade rrethuar me qindra kamera, polici, agjentë nuk e dimë ende!

Ja pse sot ngjan edhe më i mjerë e i përmjerë teksa përpëlitesh duke përdorur reputacionin moral të popullit si mburojë politike për namin e zi të pushtetit tënd të diskredituar ndërkombëtarisht.

Edi Rama do të mbahet mënd gjatë në memorien tonë si Kryeministri që kriminalizoi ekonominë, shpopulloi vendin, vrau arsimin, transformoi spitalet në kampe përqëndimi.

Ndërsa në historinë e këtij vendi do të mbetet se shqiptarët, në orën më të errët të Europës, u hapën derën hebrenjve kur kjo mund t'u kushtonte jetën. Ndërsa Rama do të mbahet mend si kryeministri që shndërroi Shqipërinë në narkoshtet e për të shpëtuar pushtetin e tij, guxoi ndyrësisht t'i linte një popull të tërë njollën e antisemitizmit./ CNA





Të sugjeruara

Konferencë e pazakontë/ Rama u drejtohet nesër shqiptarëve

Protestuesit i gjuajtën me vezë/ Rama, me batuta: U ndjeva mirë, Pjerin Ndreu erdhi me vrap

Rama me shqiptarët në New York: Diaspora ka hyrë në fazë të re, jo vetëm solidaritet

Shqipëria me Institut për të Miturit që kryejnë krime, ja kur do të jetë gati

PROFIL-Nga karriera si ushtarak, te politika/ Kush është Eric Wendt, ambasadori i ri i SHBA-së në Shqipëri

PD, letër zyrtare Peleshit: Të ngrihet Komision Hetimor për zgjedhjet e 11 majit

Takimi në Presidencë/ Zbardhen diskutimet e ambasadorit të ri të SHBA-së me Begajn

[2 shqiptare numben jeten nga tragjedia ne Rome/ Deputeti: Ministria dhe Ambasada, asnje reagim](#)

[Ministri Demo viziton Kombinatin: Nis rindërtimi për banesat e reja, pasojë nga tërmeti i 2019-ës](#)

[Fjalimi i Ramës në OKB/ Berisha: Salla bosh, bojkot Padrinos](#)

["Ripërtëritja e PD-së, jetike për vendin"/ Berisha: Situata aktuale kërkon ndërhyrje të menjëhershme](#)

["Transparencë, jo ngadalësim"/ Rama në OKB: Duhet marrëveshje ndërkombëtare për një IA sovrane](#)

["Revolucioni i Flamingove"/ Rama: U fabrikua narrativa e pushtimit të bregdetit nga izraelitët](#)

[Rama në OKB: Rreziku më i madh nga IA, t'i bindet njeriut të gabuar](#)

["Thaçi u tradhtua nga Biden"/ Rama nga New York: Sistemi demokratik i Shqipërisë po ndërton imunitet](#)

[Protestat kundër tij/ Rama: Pulat hysterike i gënjen mendja se do më ndalin me llogjet për korrupsionin](#)

["100 bashki dhe 12 qarqe"/ PD depoziton ligjin për ndarjen territoriale të vendit](#)

[Skandali i SHISH-it/ Ja kur pritet të mblidhet Këshilli i Sigurisë Kombëtare](#)

[Detajet/ Rama mban nesër fjalën e tij para OKB-së](#)


[Zbardhen diskutimet/ Ministri Hoxha takohet në New York me Kaja Kallas](#)

[editorial](#)

09:11 Editorial Bujar Leskaj

Të ndihmojmë SHISH-in të mbrojë shtetin nga krimi, dhe jo krimin nga shteti!!

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në





[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.